

# FRONTEX

ALBANIAN

## E drejta juaj për t'u ankuar pranë Frontex-it



## **Të drejtat e njeriut dhe liritë e tuaja themelore**

Ju keni të drejtën të respektoheni për integritetin tuaj fizik dhe mendor, të trajtoheni me dinjitet, keni të drejtën për azil dhe që të mos diskriminoheni. Këto janë mes të drejtave themelore dhe njihen nga ligji evropian.

Ju keni të drejtën të ankoheni nëse besoni se po shkelen të drejtat tuaja themelore në aktivitetet e Frontex-it, që është Agjencia Evropiane e Rojës Bregdetare dhe Kufirit.

Agjencia ndihmon Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (BE-së) të kontrollojnë kufijtë e jashtëm të BE-së. Ka shumë persona të përfshirë në këto aktivitete, si p.sh. oficerët që regjistrojnë të dhënat tuaja kur mbërrini në BE, personeli që ju merr gjurmët e gishtave, përkthyesit, specialistët e kontrollit me qen, shoqëruesit që shoqërojnë personat që kthehen në vendet e tyre të origjinës, doktorët dhe ndërmjetësuesit kulturorë. Të gjithë këta persona duhet t'i respektojnë drejtat tuaja themelore. Në rast të kundërt, mund t'i paraqisni Agjencisë një ankesë.

## **Kush mund të paraqesë ankesë?**

Ju mund të paraqisni ankesë, pavarësisht moshës suaj, nëse besoni se të drejtat tuaja themelore janë shkelur nga

një person që është i përfshirë në çdoqoftë aktivitet të Agjencisë.

Ju mund të përfaqësoheni gjithashtu nga një person tjetër, avokat apo organizatë, që mund ta paraqesë ankesën në emrin tuaj.

Ju mund të paraqisni ankesë pavarësisht nga situata juaj administrative në Evropë (p.sh. pavarësisht nëse keni apo jo leje të vlefshme qëndrimi ose nëse po bëni kërkesë për azil).

Nëse jeni disa persona që jeni prekur nga të njëjtat veprime, ju mund të paraqisni një ankesë të përbashkët.

## **Si ta paraqisni ankesën?**

Ju duhet ta paraqisni ankesën me shkrim dhe të jepni të dhënat tuaja të kontaktit. Nëse doni të përdorni një formular ankesash, në faqen e internetit të Agjencisë mund ta gjeni një të tillë në gjuhë të ndryshme. Ankesën mund ta dërgoni edhe me postë elektronike ose me letër.

Ju lutemi të përshkruani se si janë shkelur të drejtat tuaja, cilat të drejta janë shkelur dhe ku ka ndodhur shkelja. Ju mund të dërgoni materiale plotësuese rreth ankesës suaj në çdo kohë. Edhe Agjencia gjithashtu mund t'ju kontaktojë për informacione të mëtejshme.

Ankesën tuaj mund ta dërgoni në internet, me postë elektronike ose me letër.

**Faqja e internetit:**

<https://frontex.europa.eu/fundamental-rights/complaints-mechanism/>

**Posta elektronike:**

[complaints@frontex.europa.eu](mailto:complaints@frontex.europa.eu)

**Adresa postare:**

Frontex - European Border and Coast Guard Agency  
Fundamental Rights Officer  
Plac Europejski 6  
00-844 Warsaw  
Poland

## **Si funksionon procedura e ankesave?**

Oficeri i të Drejtave Themelore i Agjencisë, do të shqyrtojë ankesën tuaj dhe do të vendosë nëse ajo mund të procedohet. Ndryshe, ju do të njoftoheni, kur është e mundur, rreth zgjedhjeve të tjera për ankesën tuaj.

Ka kritere specifike për pranimin e ankesave. Ato mund t'i gjeni te Rregullat e Agjencisë për Mekanizmin e Ankesave në faqen e internetit të Agjencisë.

Nëse ankesa juaj mund të procedohet, ajo do t'i dërgohet Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë. Nëse në çështjen tuaj janë të përfshirë pjesëtarë personeli nga një Shtet Anëtar i BE-së, ankesa do t'u dërgohet gjithashtu edhe autoriteteve të atij Shteti Anëtar. Këto autoritete do të jenë përgjegjëse për të kthyer përgjigje rreth konstatimeve dhe për të raportuar sërish te Oficeri i të Drejtave Themelore, i cili më pas do t'ju njoftojë rreth rezultateve të çështjes suaj.

Koha që nevojitet për të proceduar një ankesë mund të varet sipas rastit. Por, Agjencia është e angazhuar që ta procedojë ankesën tuaj me efikasitet dhe t'ju kthejë përgjigje rreth saj.

Të dhënat e juaja personale (emri, të dhënat e kontaktit...) do të ndahen me autoritetet të përcaktuara, por vetëm me miratimin tuaj, dhe nuk do të përpunohet për qëllime të tjera përveç hetimit të ankesës suaj.

Rastin tuaj mund t'ia drejtoni njëkohësisht edhe institucioneve të tjera, si p.sh. gjykatave kombëtare, gjë që mund të ndihmojë gjithashtu në mbrojtjen e të drejtave tuaja.

# FRONTEX

Plac Europejski 6  
00-844 Warsaw, Poland  
T +48 22 205 95 00  
F +48 22 205 95 01

[frontex@frontex.europa.eu](mailto:frontex@frontex.europa.eu)  
[www.frontex.europa.eu](http://www.frontex.europa.eu)

© European Border and Coast Guard Agency (Frontex), 2023



Publications Office  
of the European Union



FPI 23.0269

PDF  
TT-08-23-011-SQ-N  
ISBN 978-92-9467-567-5  
doi:10.2819/443599